

V E N D I M
Nr.501, datë 5.8.1996

**PËR PRANIMET NË SHKOLLAT E LARTA NË VITIN SHKOLLOR 1996-97 TË
KANDIDATËVE SHQIPTARË NGA TREVAT JASHTË KUFIJVE TË VENDIT**

Me propozimin e Ministrisë së Arsimit të Lartë dhe Kërkimeve Shkencore, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Pranimi në shkollat e larta i kandidatëve shqiptarë nga trevat jashtë kufijve të vendit bëhet me konkurs, sipas modaliteteve që përcaktohen në statutet e shkollave të larta.

Kandidatët shqiptarë nga trevat jashtë kufijve të vendit konkurrojnë vetëm për kuotat e pranimi, të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.414, datë 10.6.1996.

Konkurset zhvillohen pranë shkollave të larta, së bashku me kandidatët nga Shqipëria.

2. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.332, datë 13.5.1996, në pikën 1, shkronja “c” shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi